
AKT THEMELIMI
PËR SHOQËRINË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SPIKE INTERNATIONAL”SHPK

Sot, më datën 30.11.2021 ortaku i vetëm si më poshtë:

Z.Giulio Maggi, atësia Leandro, amësia Maria, shtetas Italian, lindur në Al bisola Superiore (Sv) dhe banues në Torino, me adresë Via Nizza 95, lindur më 12/05/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën Italiane nr.YB4520615
redaktoi këtë Akt Themelimi për shoqërinë tregtare si më poshtë:

Bazuar në Ligjin nr,9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, hartohet ky Akt Themelimi për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me kushtet si më poshtë:

Neni 1

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**SPIKE INTERNATIONAL**”SHPK,
Me ortakun e vetëm themelues si më poshtë:

Z.Giulio Maggi, ortak themelues zotëruesi 1(një)kuote, që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë

Neni 2

Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë, me adresë :Ruga Aleksandër Moisiu, Ndërtesa 38, ap.2 Tiranë, Albania.
Selia e Shoqërisë mund të ndryshojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 3

Shoqëria themelohet për të vepruar në gjithë territorin e vendit, me afat të pacaktuar

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është;
Aktiviteti i blerjes së makinave dhe motorcikletave. Dhënje me qira të makinave , riparime të ndryshme të tyre si dhe shitje të pjesëve të ndryshme mekanike dhe xhenerike. Shitje të paisjeve dhe makinerive elektromedike, produkteve dhe artikujve të kujdesit shëndetësor të përgjithshme, kozmetike dhe produkteve të tjera specifike për kujdesin personal. Manaxhim qiraje, këmbimi dhe blerje të pasurisë së paluajtshme të cdo natyre dhe lloji. Aktivitete të shërbimeve online, krijimin, perditësimin dhe menaxhimin e siteve të internetit, sitet sociale, reklamave e logove dhe të tjera aktivitete të përgjithshme.

Neni 5

Kapitali themeltar është 100000(njëqindmijë lek) i nënshkruar në ëe holla nga ortaku i vetëm i shoqërisë , që i korrespondon 100%(një qind për qind) ëe kapitalit të shoqërisë.

Kapitali përbëhet nga 1(një) kuotë e nënshkruar dhe e pashlyer me vlerë totale prej 100000(njëqindmije lek)

Neni 6

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë është Asambleja e ortakeve që përbëhet nga ortaku i vetëm themelues, i cili zotëron i vetëm 100% pjesën e kapitalit themeltar.



Neni 7

Veprimtaria e shoqërisë drejtohet nga Administratori, i cili emerohet nga Asambleja .

Numuri I Administratoreve do te jetë 1(një).

Administratori i parë dhe i vetëm i shoqërisë emërohet **Z.Giulio Maggi**, atësia Leandro, amësia Maria, shtetas Italian, lindur në Albisola Superiore (Sv) dhe banues ne Torino, me adrese Via Nizza 95, lindur me 12/05/1968, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën Italiane nr.YB4520615

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë pasqyrohet në bilancet financiare të cdo viti ushtrimor në përputhje me dispozitat ligjore për kontabilitetin

Neni 9

Shoqëria mund të mbyllë aktivitetin e saj në rast kur:

- Vendos Asambleja e Ortakëve
- Në bazë te ligjit vendoset likuidimi I shoqërisë

Neni 10

Dispozita më të hollësishme për veprimtarinë e shoqërisë përcaktohen në statutin e saj.

Ky Akt -Themelimi përpilohet ne 3(tre)kopjo të barabarta dhe nënshkruhet nga :

ORTAKU I VETEM THEMELUES

/Giulio Maggi/


 MAECI